



Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudmana • Ombudsperson Institution

Prishtinë, më 14 korrik 2026

Z. Arben Vitia, ministër në detyrë
Ministria e Shëndetësisë
Rr. "Zagrebit" nr. 60
10 000 Prishtinë

LETËR REKOMANDIMI

R. nr. 627/2026

*Lidhur me qasjen në terapinë Pembrolizumab për pacientin e diagnostikuar me sëmundjen
C67 - Neoplazëm malinje e vezikës urinare*

I nderuar z. Vitia,

Në bazë të nenit 16, paragrafi 1¹, të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, më 14 prill 2026, në Institucionin e Avokatit të Popullit (në vijim: IAP), z. Gani Cakiqi (ankuesi) parashtoi ankesë kundër Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës (ShSKUK), me pretendime se nuk po i ofrohet terapia e nevojshme për trajtimin e sëmundjes nga e cila vuan.

Në shkresat e lëndës dhe sipas pohimeve të ankuesit, rezulton se ai u diagnostikua me sëmundjen "C67-Neoplazëm malinje e vezikës (fshikëzës) urinare". Për trajtimin e kësaj sëmundjeje, ai u udhëzua për imunoterapi pembrolizumab, terapi kjo që për të është e kushtueshme dhe të cilën ai e ka të vështirë ta sigurojë, pasi kjo nuk po i sigurohet nga ShSKUK-ja.

Më 6 maj 2026 dhe më 14 maj 2026, IAP-ja bisedoi me ankuesin me qëllim të sigurimit të sqarimeve dhe informatave shtesë relevante për shqyrtimin e rastit.

Më 25 maj 2026, Avokati i Popullit, nëpërmjet një shkrese, iu drejtua ShSKUK-së, duke kërkuar informata lidhur me veprimet e ndërmarra, si dhe për ato që pritet të ndërmerren lidhur me çështjen.

¹Avokati i Popullit ka kompetenca për t'i hetuar ankesat e pranuar nga çdo person fizik a juridik lidhur me pohimet për shkeljen e të drejtave të njeriut të parapara me kushtetutë, ligje dhe akte të tjera, si dhe me instrumente ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, veçanërisht me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, duke përfshirë veprimet apo mosveprimet që paraqesin keqpërdorim të autoritetit.

Më 8 qershor 2026, ShSKUK-ja e informoi IAP-në lidhur me rastin: “[...] Pas shqyrtimit të plotë të dokumentacionit mjekësor, përfshirë të dhënat klinike, patologjike, radiologjike dhe rezultatet e testimeve molekulare, ekipi multidisiplinar i Klinikës së Onkologjisë ka konstatuar se pacienti fillimisht është trajtuar sipas protokolleve standarde të trajtimit, me kimioterapi dhe më pas me radioterapi me qëllim kurativ. Gjatë ndjekjes së mëtejshme, është evidencuar progresion i sëmundjes. Në bazë të rezultateve të testimeve molekulare dhe vlerësimit profesional të rastit, pacientit i është rekomanduar fillimi i trajtimit me imunoterapi, respektivisht me Pembrolizumab, në kombinim me terapi të synuar (TKI), në përputhje me karakteristikat biologjike të sëmundjes dhe evidencën bashkëkohore shkencore. Rekomandimi për këtë trajtim është bazuar në të dhënat klinike të pacientit, rezultatet e analizave relevante dhe në studimet klinike ndërkombëtare që mbështesin përdorimin e imunoterapisë në indikacionin përkatës. Pacienti dhe familjarët e tij janë informuar lidhur me opsionet terapeutike të rekomanduara, përfitimet e pritshme, si dhe kushtet e sigurimit të barnave. Është sqaruar se Pembrolizumab aktualisht është i përfshirë në Listën Esenciale të Barnave të Ministrisë së Shëndetësisë së Republikës së Kosovës vetëm për indikacione të caktuara, përkatësisht për trajtimin e melanomës malinje të avancuar dhe kancerit të mushkërive në raste të përzgjedhura sipas kriterëve përkatëse dhe rezultateve të testimit PD-L1. Për rrjedhojë, për indikacionin konkret të pacientit, siguri i terapisë së rekomanduar nuk mund të realizohet nga fondi i barnave të Klinikës së Onkologjisë, dhe pacienti është njoftuar se siguri i saj mbetet përgjegjësi e vetë pacientit ose përmes mekanizmave të tjerë të financimit të paraparë me legjislacionin në fuqi. Megjithatë, me qëllim të sigurimit të vazhdimësisë së trajtimit dhe ofrimit të mundësive terapeutike të disponueshme, pacienti ka vazhduar trajtimin me një preparat tjetër imunologjik, i cili është siguruar përmes programit të donacionit në Klinikën e Onkologjisë. Ky trajtim është ofruar në përputhje me indikacionet mjekësore, disponueshmërinë e barit dhe vlerësimin profesional të ekipit mjekësor. [...]”

Më 11 qershor 2026, përfaqësuesi i IAP-së bisedoi me ankuesin, të cilin e njoftoi lidhur me përgjigjen që mori nga ShSKUK-ja. Po ashtu, ankuesi bëri të ditur se situata lidhur me sigurimin e terapisë së rekomanduar, për të cilën paraqiti ankesë, mbetet e pandryshuar.

Avokati i Popullit, pas analizimit të rrethanave të rastit dhe dokumentacionit të çështjes, vëren se në rastin konkret nuk ekziston ndonjë mospajtim profesional lidhur me nevojën mjekësore për trajtimin e rekomanduar. Përkundrazi, vetë autoritetet publike shëndetësore kanë konfirmuar se trajtimi me Pembrolizumab është rekomanduar nga ekipi shumëdisiplinar, bazuar në gjendjen klinike të pacientit, rezultatet e testimeve molekulare dhe evidencën bashkëkohore shkencore. Prandaj, çështja kryesore e ngritur në këtë rast lidhet me mungesën e qasjes efektive në terapinë e rekomanduar.

Avokati i Popullit rikujton se neni 51 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës garanton mbrojtjen shëndetësore dhe obligon institucionet publike që të krijojnë kushte për realizimin efektiv të kësaj të drejte. Po ashtu, Avokati i Popullit vlerëson se qasja në kujdes shëndetësor nuk nënkupton vetëm ekzistimin formal të institucioneve shëndetësore, por edhe mundësinë reale që pacientët të marrin trajtimin e nevojshëm me kohë, veçanërisht në rastet e sëmundjeve të rënda dhe potencialisht kërcënuese për jetën.

Në këtë kontekst, Avokati i Popullit në dhjetor të vitit 2024 publikoi raportin me rekomandime në lidhje me ndërmarrjen e veprimeve përkatëse në drejtim të zgjerimit të Listës së Barnave Esenciale, duke përfshirë barna të reja që mund të përmirësojnë ndjeshëm

shëndetin dhe cilësinë e jetës së qytetarëve që vuajnë nga sëmundje të renda². Në atë raport u konstatua se mungesa e qasjes në barna inovative dhe terapi të avancuara përbën problematikë sistematike në sektorin e shëndetësisë. Në raport u rekomandua që Ministria e Shëndetësisë ta plotësojë/ndryshojë Listën e Barnave Esenciale dhe të përfshijë në këtë listë terapitë: “braf pozitiv” për të sëmurët me melanomë të avancuar; “Pirfenidone-267 mg” për të sëmurët me fibrozë idiopatike pulmonare. Gjithashtu, të sëmurëve me karcinomë metastatike në mëlçi t’u mundësojë qasje falas në imunoterapi “pembrolizumab”, që është në Listën e Barnave Esenciale.

Rasti në shqyrtim paraqet një shembull konkret të problematikës së identifikuar në raportin e lartcekur. Vetë autoritetet shëndetësore kanë pranuar se ekziston indikacion mjekësor për përdorimin e Pembrolizumab-it, por që është thënë se terapia nuk mund të sigurohet për shkak se indikacioni konkret nuk mbulohet nga Lista Esenciale e Barnave.

Avokati i Popullit konsideron se në rastet kur trajtimet potencialisht jetike kushtëzohen nga gjendja ekonomike e pacientëve, cenojnë parimin e qasjes së barabartë në kujdesin shëndetësor, përkatësisht paragrafin 2 të nenit 4 të Ligjit për Shëndetësi, ku thuhet: *“Të gjithë qytetarët dhe banorët kanë të drejtë të qasjes së barabartë në kujdesin shëndetësor.”*

Megjithëse Avokati i Popullit vëren se Klinika e Onkologjisë, me qëllim të sigurimit të vazhdimësisë së trajtimit, i ka ofruar ankuesit një alternativë terapeutike përmes një programi donacioni, vlerëson se kjo nuk e eliminon nevojën për adresimin e problemit në nivel sistematik dhe institucional.

Avokati i Popullit, në pajtim me nenin 135, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës: *“Ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa, nëse vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e organeve të administratës publike dhe organeve të tjera shtetërore”*; dhe sipas nenit 18, paragrafi 1, nënparagrafi 1.2, të Ligjit për Avokatin e Popullit duhet: *“Të tërheq vëmendjen për rastet kur autoritete i shkelin të drejtat e njeriut dhe të bëjë rekomandim që t’u jepet fund rasteve të tilla.”*

Prandaj, Avokati i Popullit i

REKOMANDON

Ministrisë së Shëndetësisë:

- Ta shqyrtojë me prioritet mundësinë e sigurimit të terapisë Pembrolizumab për ankuesin, duke marrë parasysht rekomandimin e ekipit shumëdisiplinar të Klinikës së Onkologjisë dhe gjendjen e tij shëndetësore.

Në pajtim me nenin 132, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (*“Çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t’u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t’i paraqes atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara në pajtim me ligj.”*) dhe në pajtim me nenin 28 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit (*“Autoritete, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandim, kërkesë ose propozim për ndërmarrjen e veprimeve konkrete, duhet të*

² <https://oik-rks.org/2024/12/20/raport-i-avokatit-te-popullit-a-nr-526-2023-r-nr-812-2024-dhe-r-nr-867-2024-ne-lidhje-me-ndermarrjen-e-veprimeve-perkatese-ne-drejtimit-te-zgjerimit-te-listes-se-barnave-esenciale-duke-perfshire-ba/>

përgjigjen brenda afatit tridhjetë (30) ditor. Përgjigja duhet të përmbajë arsyet me shkrim për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë.”), ju lutemi mirësisht të na informoni për veprimet që do t’i ndërmerreni lidhur me këtë çështje.

Me nderime,

Naim Qelaj
Avokat i Popullit

